a	NGA GRANTI		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1	Paga	600	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Fondi i veçantë	6009	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Sigurime Shoq. & Shëndet.	601	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Shpenzime Operative	602	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
b	NGA TË ARDHURAT		3330	277	277	277	277	277	277	277	278	278	278	278	279
1	Paga	600	2736	228	228	228	228	228	228	228	228	228	228	228	228
2	Fondi i veçantë	6009	137	11	11	11	11	11	11	11	12	12	12	12	12
3	Sigurime Shoq. & Shëndet.	601	457	38	38	38	38	38	38	38	38	38	38	38	39
4	Shpenzime Operative	602	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (a+b)		3330	277	277	277	277	277	277	277	278	278	278	278	279

BUXHETI PËR VITIN 2016, SIPAS PROGRAMEVE, KLASIFIKIMIT EKONOMIK DHE BURIMEVE TË FINANCIMIT

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Sipas Strukturës Ekonomike					Totali	Sipas Burimeve të Financimit				
			Paga	Sigurime Shoqërore	Shpenzime Operative	Transferta 604-651	Investime		Transfertë pakushtëz.	Të ardhurat vendore	Transferta Specifike	Tranferta e Kushtëzuar	Donatorë
1	P ₁	358163. ⁷⁶	230384. ⁰⁰	36698. ⁰⁰	55928. ⁰⁰	20405. ⁷⁶	14748. ⁰	358163. ⁷⁶	123796. ⁰	225671. ⁷⁶		7868. ⁰	828. ⁰
2	P ₂	72699. ⁰⁰	10410. ⁰⁰	1689. ⁰⁰	600. ⁰⁰	13000. ⁰⁰	47000. ⁰	72699. ⁰⁰	24628. ⁰	43114. ⁰⁰	4957. ⁰⁰		
3	P ₃	364954. ⁷⁵	39500. ⁶⁵	6554. ⁸⁰	240121. ³⁰		78778. ⁰	364954. ⁷⁵	58732. ⁰	280488. ⁰⁰	25734. ⁷⁵		
4	P ₄	13720. ⁵⁰	9546. ⁰⁰	1529. ⁴⁰	350. ⁰⁰		2295. ¹	13720. ⁵⁰		9793. ⁰⁰		1632. ⁴	2295. ¹
5	P ₅	87643. ¹²	12674. ⁰⁰	2062. ¹²	16407. ⁰⁰		56500. ⁰	87643. ¹²	2940. ⁰	5019. ⁰⁰	79684. ¹²		
6	P ₆	15917. ⁹²	13416. ²⁶	2152. ⁸³	348. ⁸³			15917. ⁹²	5064. ⁰	7788. ⁰⁰	3065. ⁹²		
7	P ₇	198240. ⁹⁰	119760. ⁰⁰	19797. ⁰⁰	25738. ⁹⁰	26865. ⁰⁰	6080. ⁰	198240. ⁹⁰	16730. ⁰	38112. ⁰⁰	143398. ⁹⁰		
8	P ₈	3336. ⁰⁰			3336. ⁰⁰			3336. ⁰⁰		3336. ⁰⁰			
9	P ₉	20884. ⁰⁰	16636. ⁰⁰	2646. ⁰⁰	1602. ⁰⁰			20884. ⁰⁰	6720. ⁰	14164. ⁰⁰			
10	P ₁₀	50000. ⁰⁰	17112. ⁰⁰	2724. ⁰⁰	30164. ⁰⁰			50000. ⁰⁰	2676. ⁰	47324. ⁰⁰			
11	F.rezervë	5000. ⁰⁰				5000. ⁰⁰		5000. ⁰⁰	3233. ⁴	1766. ⁶⁰			
12	F.Kontigj.	5000. ⁰⁰				5000. ⁰⁰		5000. ⁰⁰	1836. ⁰	3164. ⁰⁰			
	TOTALI	1195559.⁹⁵	469438.⁹¹	75853.¹⁵	374596.⁰³	70270.⁷⁶	205401.¹	1195559.⁹⁵	246355.⁴	679740.³⁶	256840.⁶⁹	9500.⁴	3123.¹
	Në %	100	39.³	6.³	31.³	5.⁹	17.²	100	20.⁶	56.⁸	21.⁵	0.⁸	0.³

DETAJIMI I FONDIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2016

Nr	Emërtimi i Projektit	Vlera 000/lekë	Burimi i Finnacimit			
			Grant	Ardhura	Buxh. Shtetit	Donator
1	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Hotel “Antag” – Rruga Kunes	7000	7000			
2	Sistemim sheshi dhe ndërtim K.U.B në fshatin Tresh	20000	20000			
3	Rikonstruksioni i Shkollës Kodhel	5000	5000			
4	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës fshati Barbullojë e Re (1 km)	15000	15000			
5	Rikonstruksioni i zyrave për administratën ish-Banka Lezhë	10000	10000			
6	Blerje paisje për zyra	3920	3920			
7	Likujdim investimesh prapambetura	34148	20000	14148		
8	Blerje paisje për ngrohje (soba për shkollat)	960	960			
9	Blerje paisje për ngrohje (soba për çerdhet)	120	120			
10	Blerje pompë uji për Stacionin e Pompave Spiten	630	630			
11	Blerje paisje kompjuterike	828				828
12	Projekte dhe promovim turizmi	2295. ¹				2295. ¹
13	Rehab.i skemave ujitëse Mat-Lezhë,Kotërr-Rrabosht,Kallmet & Fishtë	56500			56500	
14	Shpronësime	25000		25000		
15	Blerje automjeti për administratën	4000	4000			
16	Blerje paisje elektrike (Transformator)	1500	1500			
17	Rikonstruksioni i rrugës Kotërr-Dajç	18500	4090	14410		
	TOTALI	205401.¹	92220	53558	56500	3123.¹



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LEZHË
KRYETARI

Bashkia Lezhë, Lagjja "Skënderbej", Sh."Gjergj Kastrioti", 4501 Lezhë, Nr. Tel.00355 215 22270, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al

RELACION

MBI HARTIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LEZHË PËR VITIN 2016

Të nderuar këshilltarë;

Projektbuxheti i vitit të parë pas reformës territoriale, i është referuar analizave të problemeve të konstatuara, të sfidave emërgjente, programeve dhe projekteve afat-shkurta e afatmesme. Por siç e dini, ish-Bashkia Lezhë dhe komunat, gjatë viteve të fundit 2012-2015, kanë mbartur disa vështirësi financiare, duke krijuar borxhe në vite të cilat këto do të japin ndikimin e tyre në buxhetin e vitit 2016. Përballë kësaj situatë, për vitin 2016 janë parashikuar fonde në buxhet për likuidimin e një pjese të tyre, fonde që do të përdoren kryesisht për shërbimet dhe investimet kryera.

Gjatë këtij viti do të punohet në maksimumin e mundshëm në përmbushjen e detyrave, përgjegjësi dhe premtimeve tona. Në radhë të parë përgjegjësinë e shohim në zbatimin me korrektësi të ligjit, në përdorimin e parave në mënyrë efçente dhe për gjërat e duhura, me besim se vetëm kështu mund të ndryshohet dhe zhvillohet Lezha. Për këtë po punohet në radhë të parë për ndërtimin dhe fuqizimin e administratës si një instrument thelbësor. Rekrutimi i burimeve njerëzore cilësore është synimi ynë. Trajtimi i administratës dhe modernizimi i punës së saj do të jetë një ndër kërkesat e të vazhdueshme në të ardhmen.

Në hapësinë territoriale të Lezhës, kemi zona me diferenca të dallueshme për sa i përket infrastrukturës rrugore, shërbimeve publike, gjendjes fizike të objekteve të arsimit dhe të shërbimeve të tjera, të gjendjes ekonomike dhe sociale të komuniteteve.

Përmirësimi në vijimësi, sidomos i shërbimeve publike, pastrimi dhe mbrojtja e mjedisit, mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore ekzistuese, përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, ndriçimi i ambjenteve publike, rehabilitimi i veprave ujitëse e kulluese, rritja e sigurisë, përmirësimi i shërbimeve dhe kushteve për zhvillimin e biznesit, përmirësimi i kushteve dhe standardeve të infrastrukturës arsimore e shëndetësore, promovimi i territorit me vlerat e veta natyrore, turistike, të trashëgimisë, të artit, të kulturës e traditës, zhvillimi i agroturizmit, kujdesi dhe shërbimet për fëmijët, për të rinjtë, për persona me aftësi ndryshe, mbrojtja e vlerave, zhvillimi e promovimi i historisë, gjallërimi i jetës kulturore, artistike dhe sportive, etj do të jenë sfidat për Bashkinë Lezhë.

Për hartimin e Buxhetit të vitit 2016, ne jemi referuar dhe mbështetur në;

- Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore".
- Ligjin Nr.8399, datë 09.09.1998 "Për Buxhetin Lokal", i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Ligjin Nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”.
- Udhëzimin e Ministrës së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit për vitin 2016”.
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.4/1, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Buxhetit Vendor”.
- Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- V.K.M Nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga M.B.ZH.R.A.U, te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes e kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”.
- V.K.M Nr.915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve, te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”.
- Në objektivat dhe angazhimet e bashkisë Lezhë për të rritur shërbimet ndaj komunitetit dhe përmirësuar cilësinë e tyre.
- Në analizën e realizimit të treguesve ekonomiko-financiare të vitit 2015, tregues të cilët na shërbyen dhe si bazë për një programim sa më real të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin 2016.
- Në kapacitetin fiskal dhe nivelin e taksave dhe tarifave të miratuar nga këshilli i bashkisë Lezhë me vendimin Nr.124, datë 15.04.2016.
- Në nivelin e pagave të punonjësve të miratuar nga këshilli për vitin 2016 me vendimin Nr. 117, datë 15.04.2016 dhe numrin e punonjësve të paraqitur për miratim me anë të këtij buxheti.

Buxheti i Bashkisë Lezhë për vitin 2016 është **1.195.559.⁹⁵** mijë lekë, ku; transferta e pakushtëzuar është 230.553.³ mijë lekë, e cila zënë 19.²⁸ % në totalin e buxhetit; të ardhurat tatimore e jotatimore janë 660.450 mijë lekë që zënë 55.²⁴ % në totalin e buxhetit, transferta e kushtëzuar është 9.500.⁴ mijë lekë e cila zënë 0.⁸⁰ % në totalin e buxhetit; transferta specifike është 256.840.⁶⁹ mijë lekë, e cila zënë 21.⁴⁸ % në totalin e buxhetit; të ardhurat dhe granti i trashëguar nga viti 2015 janë 35.092.⁴⁶, të cilat zënë 2.⁹⁴ % në planin e buxhetit të vitit 2016 dhe të ardhurat nga donatorët (DLDP dhe Koperacioni Italian) janë 3.123.¹ mijë lekë që zënë 0.²⁶ në buxhet .

Tab.1. Planifikimi i buxhetit sipas programeve është;

Nr	Programe Buxhetore	Buxheti 000/lekë	Në %
P ₁	Planifikim, Menaxhim, Administrim	358163. ⁷⁶	30. ⁰
P ₂	Infrastruktura Rrugore	72699. ⁰⁰	6. ¹
P ₃	Shërbimet Publike	364954. ⁷⁵	30. ⁵
P ₄	Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	13720. ⁵⁰	1. ¹
P ₅	Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	87643. ¹²	7. ³
P ₆	Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	15917. ⁹²	1. ³
P ₇	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	198240. ⁹⁰	16. ⁶
P ₈	Strehimi dhe Shërbimet Sociale	3336. ⁰⁰	0. ³
P ₉	Kultura dhe Shërbimet Rekreacionale	20884. ⁰⁰	1. ⁸
P ₁₀	Rinia dhe Sportet	50000. ⁰⁰	4. ²
	Fondi Rezervë	5000. ⁰⁰	0. ⁴
	Fondi i Kontigjencës	5000. ⁰⁰	0. ⁴
	TOTALI I SHPENZIMEVE	1195559.⁹⁵	100

Tab.2. Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik është;

000/lekë

Emërtimi	Detajimi sipas strukturës ekonomike							TOTALI
	Paga + Sigurime	Shpenz. Operative	Subven-sione	Transferta	Investime	Fondi Rezervë	Fondi Kontigj.	
Në vlerë	545282. ⁰⁶	374596. ⁰³	0	60270. ⁷⁶	205401. ¹	5000	5000	1195559. ⁹⁵
Në %	45. ⁶	31. ³³	0	5. ⁰³	17. ²	0. ⁴²	0. ⁴²	100

Tab.3. Planifikimi i buxhetit sipas funksioneve

Nr	Funksionet	Në 000/lekë	Në %
1	Administrata vendore	358163. ⁷⁶	29. ⁹⁵
2	Arsimi parashkollor dhe parauniversitar	198240. ⁹⁰	16. ⁶⁰
3	Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane	74000. ⁰⁰	6. ²⁰
4	Ndërtimi, mirëmbajtja e varrezave publike dhe shërbimi funeral	3000. ⁰⁰	0. ²⁵
5	Mirëmbajtja parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbërta	20000. ⁰⁰	1. ⁶⁵
6	Shërbimi i dekorit publik	3000. ⁰⁰	0. ²⁵
7	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuarëve e shesheve publike.	281372. ⁰⁰	23. ⁵³
8	Administrimi i shërbimeve sociale për shtesat në nevojë, personat me aftësi kufizuar, fëmijët, gratë dhe të moshuarit.	2880. ⁰⁰	0. ²⁴
9	Org.aktiviteteteve sportive, zhvillimi dhe administrimi i objekteve dhe institucioneve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve	50000. ⁰⁰	4. ²⁰
10	Ndriçimi i mjediseve publike	24000. ⁰⁰	2. ⁰⁰
11	Org.aktiviteteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e tyre	6604. ⁰⁰	0. ⁵⁵
12	Emërgjencat civile dhe PMNZSH-ja	33281. ⁷⁵	2. ⁷⁵
13	Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale	456. ⁰⁰	0. ⁰⁴
14	Administrimi i infrastrukturës ujtitëse dhe kullimit, si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni	87643. ¹²	7. ³⁰
15	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekës dhe ambjenteve për lexim	7732. ⁰⁰	0. ⁶⁵
16	Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit	0. ⁰⁰	0
17	Administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore dhe menaxhimi i tyre	15917. ⁹²	1. ³⁰
18	Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm	0. ⁰⁰	0. ⁰⁰
19	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore e historike me interes lokal dhe administrimi i objekteve historike	6548. ⁰⁰	0. ⁵⁵
20	Zhvillimi i turizmit	13720. ⁵⁰	1. ¹⁵
21	Programe dhe projekte rinore	0. ⁰⁰	0. ⁰⁰
22	Publikim i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik	0. ⁰⁰	0. ⁰⁰
23	Mbështetja për zhvillimin e biznesit nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vendet publike	0. ⁰⁰	0. ⁰⁰
24	Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik	0. ⁰⁰	0. ⁰⁰
25	Fondi rezervë	5000. ⁰⁰	0. ⁴²
26	Fondi i kontigjencës	5000. ⁰⁰	0. ⁴²
	TOTALI	1.195.559.⁹⁵	100

Disa tregues të rëndësishëm të buxhetit janë;

- + Të ardhurat nga taksat janë 510.110 mijë lekë dhe zënë 76.⁸⁸ % në totalin e të ardhurave nga burimet e veta.
- + Të ardhurat nga tarifatat vendore janë 104.010 mijë lekë dhe zënë 15.⁶⁷ % në totalin e të ardhurave nga burimet e veta.
- + Të ardhurat nga burimet e tjera janë 46.330 mijë lekë dhe zënë 6.⁹⁸ % në totalin e të ardhurave nga burimet e veta.
- + Të ardhurat nga donatorët janë 3.123.¹ mijë lekë dhe zënë 0.⁴⁷ % në totalin e të ardhurave nga burimet e veta.
- + Totali i shpenzimeve kapitale është 205.401.¹ mijë lekë, ku zënë 17.² % në totalin e shpenzimeve.
- + Totali i shpenzimeve operative është 374.596.⁰³ mijë lekë dhe zënë 31.³ % në totalin e shpenzimeve.
- + Totali i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është 545.282.⁰⁶ mijë lekë dhe zënë 45.⁶ % në totalin e shpenzimeve.
- + Të tjera shpenzime janë 70.270.⁷⁶ mijë lekë dhe zënë 5.⁹ % në totalin e shpenzimeve.

Buxheti i vitit 2016 është hartuar sipas programeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj. Për këtë vit, si viti i parë pas reformës administrativo-territoriale, ka qenë e vështirë, mbledhja dhe analizimi i të dhënave për planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si rezultat i;

- Mungesës të një plani menaxhimi dhe analize të hollësishme për sektorin e shërbimeve publike (mbledhja-grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, ndriçimi rrugor, gjelbërimi, mirëmbajtje infrastrukturë rrugore, mirëmbajtje rrugë rurale, ofrimi e menaxhimi i shërbimit furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të ndotura, mirëmbajtje të objekteve të arsimit parashkollor, 9 vjeçar dhe të mesëm, mirëmbajtje të objekteve të tjera të shërbimeve, etj);
- Mungesës së analizës së kostove sipas standarteve për shërbimet publike;
- Mungesës së bazës së të dhënave të plota për bizneset;
- Mungesës së bazës së të dhënave të plota për familjet dhe individët;
- Mungesës së bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Mungesës së bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Mungesës së bazës së të dhënave për zënien e hapësirave publike;
- Mungesës të një plani për parkimin publik, etj;

Formulimi i buxhetit të vitit 2016 është një risi përse i përket metodologjisë së ndjekur për hartimin e tij, ku janë zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i orientuar drejt shërbimit dhe zhvillimit. Planifikimi është bërë mbi bazën e politikave programore dhe funksionale, me tregues sasiorë të monitorueshëm në çdo kohë gjatë procesit të zbatimit dhe realizimit, nga çdokush, si nga administrata vendore, nga këshilltarët, shoqëria civile, dhe nga çdo qytetar.

I. Të Ardhurat e Bashkisë për vitin 2016

Për vitin 2016 të ardhurat në total të bashkisë, nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë 1.145.559.⁹⁵ mijë lekë.

Këto të ardhura, sipas ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vijnë nga dy burime kryesore, e konkretisht;

1.Nga burimet qendrore; me vlerë totale prej 496.894.⁴¹ mijë lekë, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar prej 230.553.³² mijë lekë , transfertat e kushtëzuar prej 9.500.⁴ mijë lekë

dhe transferta specifike për funksionet e reja që i transferohen bashkisë prej 256.840.690 lekë.

2. Nga burimet e veta vendore; me vlerë prej 663.753.¹ mijë lekë, ku futen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore) prej 510.110 mijë lekë, jo tatimore (nga tarifatat për shërbimet publike që ofrohen) prej 104.010 mijë lekë, të ardhurat e tjera vendore prej 46.330 mijë lekë dhe të ardhurat nga donacionet prej 3123.¹ mijë lekë.

Për vitin 2016, duke përfshirë të ardhurat dhe grantin e trashëguar prej 35.092.⁵ mijë lekë, transfertën e pakushtëzuar prej 230.553.³ mijë lekë, 663.573.¹ mijë lekë (të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore, të ardhurat e tjera dhe të ardhurat nga donatorët), parashikohen të përdoren 929.218.⁹ mijë lekë nga të ardhurat e veta.

1/1. Të ardhurat e veta vendore; përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës pakushtëzuar. Planifikimi i të ardhurave të veta është realizuar si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me njësitë administrative, me institucionet dhe agjentët tatimor, etj.

Të ardhurat nga burimet e veta llogariten në shumën prej 660.450 mijë lekë, ku pjesën më të madhe të tyre e zënë të ardhurat nga taksat prej 77.² %. Niveli i taksave, mënyra e llogaritjes, mbledhja dhe administrimi i tyre është bërë në mbështetje të:

- Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- Ligjit Nr.9920, datë 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh”, i ndryshuar.
- Vendimit Këshillit të Bashkisë Lezhë Nr.124, datë 15.04.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Lezhë”.

1/1. Të ardhurat nga taksat vendore;

Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë, i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave për miratimin, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Diskutimet e bëra me grupet e interesit (me komunitetin e biznesit), përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarët, etj, janë pasqyruar disa politika të rëndësishme në uljen e disa niveleve të taksave, sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- Uljen e taksës së ndërtesës dhe taksës së truallit prej 30 %, nga referenca ligjore.
- Taksa 0 (zero) për grupet në nevojë (familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, apo familjet që në përbërjen e tyre kanë të verbër, të sëmurë paraplegjike e tetraplegjike, pensionistët e vetmuar) dhe invalidët.
- Uljen e taksës së tabelës dhe të reklamës.
- Uljen e taksës së fjetjes në hotele në masën 30 %.
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30 % të taksës së tokës bujqësore, për të gjitha kategoritë e saj.

Të ardhurat nga taksat përbëjnë rreth 77.² % të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë. Pjesë e rëndësishme e taksave vendore është taksa mbi pasurinë, e cila është parashikuar të jetë 100.530 mijë lekë, ku zënë 19.⁷ % e të ardhurave gjithsej nga taksat. Në të ardhurat tatimore të parashikuara peshën më të madhe specifike e zënë të ardhurat nga taksa e ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja që zënë rreth 60.⁸ % e të ardhurave gjithsej nga taksat.

a. Të ardhurat tatimore:

Për zërin e taksës mbi ndërtesat, është mbajtur parasysh numri i familjeve banuese rezidente në qytete e fshatra, të cilat i nënshtrohen pagesës për taksën mbi pasurinë si dhe sipërfaqet në m² të objekteve në pronësi apo përdorim dhe numrit të bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Lezhës, që kanë në pronësi apo në përdorim objekte.

Në zërin e tatimit të thjeshtuar të fitimit mbi biznesin e vogël është mbajtur parasysh numri i bizneseve të regjistruara në Q.K.B^{it} dhe në Drejtorinë e Tatimeve, numri i bizneseve të kaluara në regjistrin pasiv dhe numri i bizneseve të paregjistruara apo informale. Për të gjithë

janë bërë llogaritjet për t'ju vjelë taksa vendore mbi biznesin e vogël. Për bizneset me xhiro nën 5 milion lekë tatimi i thjeshtuar i fitimit është zerua. Për bizneset me xhiro mbi 5 milion lekë parashikimi është bërë me llogaritje të përafërt të fitimit të tyre. Në këtë zë janë përfshi edhe detyrimet e pashlyera deri me 31.12.2015. Në total janë parashikuar të merren nga ky zë rreth 45.000 mijë lekë.

Në zërin e taksës mbi tabelën janë përfshirë të ardhurat që do vijnë si rezultat i taksës për tabelën për qëllime identifikimi dhe tabelës për qëllime reklamuese. Në total të ardhurat për këtë zë llogariten në shumën e 12.830 mijë lekë.

b. Të ardhurat jotatimore, janë planifikuar në përputhje me kapacitetin fiskal, ku të ardhurat nga shërbimet publike janë planifikuar në masën e 81.200 mijë lekë, dhe peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave urbane, e cila është planifikuar në shumën prej 77.090 mijë lekë, që zë rreth 51.³ % e të ardhurave jotatimore gjithsej. Me kujdes janë parashikuar të ardhurat nga përdorimi i pronave publike dhe dhënies së liçencave e autorizimeve.

Ne zërin të ardhura të tjera, janë planifikuar 63.440 mijë lekë. Këtu futen zërat si; të ardhurat nga tarifa e parkimit të mjeteve në rrugët e qytetit, të ardhurat nga shitja e biletave të hyrjes në zonën muzeale, dhe të ardhurat e tjera (detyrimet e prapambetura).

Në zërin e tarifës për zënie e hapësirave publike, pikësynimi ynë është lirimi i hapësirave publike për qytetarët, por pa cënuar iniciativën e bizneseve për shfrytëzimin e hapësirave të lejueshme. Totali i vlerës që pritet të arkëtohet nga ky zë është në shumën prej 13580 mijë lekë.

Si përfundim, në total plani i të ardhurave tatimore e jotatimore për vitin 2016, që vijnë si rezultat i aplikimit të taksave e tarifave vendore në gjithë territorin e bashkisë Lezhë, por dhe si rezultat i aktivitetit ekonomik të bashkisë, janë parashikuar në shumën 660.450 mijë lekë.

I/2. Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit; është e ardhur pa kusht kthimi, pa interes, e përfituar me ligj, e cila do të përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e bashkisë, të përcaktuara në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ku 40 % e saj do të përdoret vetëm për investime.

Formula e re e ndarjes së transfertës pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime, duke u bazuar tek popullsia relative (banorë rezidentë efektivë), e cila llogaritet mbi bazën e numrit popullsisë sipas regjistrit të gjendjes civile (106973 banorë), nr. popullsisë sipas Censurit të vitit 2011, normës së rritjes së popullsisë në vite dhe një shtese prej 30 % midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile. Nga kjo formulë bashkia ka si burim përfitim 94 % të grantit pakushtëzuar ose 217.273.⁵ mijë lekë (79500 banorë me 2.733 lekë për frymë). Referuar treguesit të dendësisë së popullsisë bashkia jonë përfiton 0 (zero) lekë grant, pasi të jesh përfituese duhet që numri i popullsisë për km² duhet të jetë nën 110 % të mesatares së Republikës prej 118 banorë/km², ku realisht dendësia e popullsisë në Bashkinë Lezhë është 234.¹⁸ banorë për km² (numri i popullsisë 106973 banorë ÷ 456.⁸ km² sipërfaqja e bashkisë). Mbi bazën e numrit të nxënësve në shkollat publike nëntëvjeçare e të mesme bashkia përfiton 13.279.⁸² mijë lekë (10391 nxënës x 1278 lekë/nx.) ose 6 % e grantit të pakushtëzuar.

Përveç ekulazimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, në formulën e re të ndarjes së transfertës pakushtëzuar në shkallë vendi është edhe ekulazimi i kapacitetit fiskal (të ardhurave nga taksat, të ndara mes pushtetit qendror e atij vendor, si tatimi i fitimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël, taksa e automjeteve të përdorura, dhe taksa e kalimit të pasurisë). Referuar kësaj formule është përdorur një mekanizëm tranzitor që i siguron çdo njësie vendore minimalisht 85 % e transfertës të vitit të mëparshëm. Përfitues të transfertës prej 15 % janë ato njësi që kanë të ardhura për frymë nën 75 % e të ardhurës mesatare kombëtare që është 930 lekë/frymë.

I/3. Transferta specifike dhe e kushtëzuar sipas funksioneve;

1.Konvikti i arsimit parauniversitar (arsimi i mesëm profesional).

Në transfertën e vitit 2016, Bashkisë Lezhë i janë akorduar fonde për konviktin në vlerën 12.729.⁹ mijë lekë, ku përfshihen: fondi për paga (6.900 mijë lekë), sigurime shoqërore e shëndetësore (1.140 mijë lekë) të personelit prej 15 punonjës e edukatorë, shpenzime operative (918 mijë lekë) dhe për bursat (3.771.⁹ mijë lekë).

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

2.Shërbimi i mbrojtës nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH).

Në transfertën e vitit 2016 janë akorduar fonde për sektorin e PMNZSH në vlerën 25.734.⁷⁵ mijë lekë, ku përfshihen: fondi për paga (20.098.⁶⁵ mijë lekë) sigurime shoqërore e shëndetësore (3.468.⁸ mijë lekë) për 30 punonjës dhe shpenzime operative (2.167.³ mijë lekë). Nga përllogaritjet e bëra rezulton se për mirëfunksionimin e këtij sektori fondet e akorduara për shpenzimet operative janë të pamjaftueshme, ku për këto mungesa është kërkuar që nga Ministria e linjës të akordohet fonde shtesë, dhe në rast të kundërt do shikohet mundësia e mbështetjes me fondet e veta të bashkisë.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

3.Shërbimi i Gjendjes Civile.

Në transfertën e kushtëzuar të vitit 2016 janë akorduar fonde për këtë funksion në vlerën 7.868 mijë lekë, ku përfshihet: fondi për paga (6.740 mijë lekë) dhe për sigurime shoqërore e shëndetësore (1.128 mijë lekë) për 11 punonjës.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

4.Arsimi parashkollor, bazë dhe parauniversitar.

Në transfertën e vitit 2016 janë akorduar fonde për këto funksione, për personelin edukativ e ndihmës të arsimit parashkollor, fonde për personelin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, fonde për personelin ndihmës të arsimit bazë dhe parauniversitar, ku në këtë fond nuk përfshihet personeli ndihmës i arsimit të mesëm profesional.

Për arsimin parashkollor, për edukatorë dhe punonjës të kopshteve të fëmijëve dhe Q.K.F janë akorduar 69.917 mijë lekë, ku përfshihet; fondi për paga (59.912 mijë lekë) dhe fondi për sigurime shoqërore e shëndetësore (10.005 mijë lekë) për 99 punonjës.

Për arsimin bazë 9 vjeçar (punonjës të shërbimit mbështetës) janë akorduar 25.530 mijë lekë, ku përfshihen; fondi për paga (21.877 mijë lekë) dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (3.653 mijë lekë) për 55 punonjës.

Për arsimin e mesëm (punonjës të shërbimit mbështetës) janë akorduar 8.357 mijë lekë, ku përfshihet; fondi për paga (7.161 mijë lekë) dhe fondi për sigurime shoqërore e shëndetësore (1.196 mijë lekë) për 18 punonjës.

Gjithashtu për vitin 2016 janë akorduar edhe 26.865 mijë lekë për transportin e nxënësve dhe mësuesve.

Ndërsa nevojat për shpenzime operative do të përballohen nga fondet e veta të bashkisë, të cilat janë pasqyruar në buxhetin e këtij viti.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

5.Administrimi i Pyjeve.

Transferta e akorduar për këtë funksion për vitin 2016 është 3.065.⁹² mijë lekë, për 5 punonjës ku përfshihet; fondi për paga (2.328.²⁶ mijë lekë) fondi për sigurime shoqërore e shëndetësore

(388.⁸³ mijë lekë) dhe shpenzime operative (348.8³ mijë lekë).

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

6.Ujitja dhe Kullimi.

Transferta e akorduar për këtë funksion për vitin 2016 është 79.684.¹² mijë lekë, ku përfshihet; fondi për paga (5.807 mijë lekë), për sigurime shoqërore e shëndetësore (970.¹² mijë lekë) për 11 punonjës, shpenzime operative e pastrim kanalesh (16.407 mijë lekë) dhe 56.500 mijë lekë për investime.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

7.Rrugët Rurale.

Në transfertën specifike të vitit 2016 për rrugët rurale janë akorduar 4.957 mijë lekë, ku përfshihet; fondi për paga 4.248 mijë lekë dhe për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 709 mijë lekë për 10 punonjës.

Ky sektor për vitin 2016 do të mbështetet edhe me fondet e veta të bashkisë, për të mundur mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e disa rrugëve të dëmtuara në vite.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

8.Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në transfertën e kushtëzuar të vitit 2016 për Q.K.Biznesit janë akorduar 1.632.⁴ mijë lekë, ku përfshihet; fondi për paga 1.356 mijë lekë, për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 226.⁴ mijë lekë për 2 punonjës, si dhe për shpenzimet operative 50 mijë lekë.

Standartet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë sektor.

Për disa funksione të mësipëme dhe sipas ligjit nga ana e bashkisë janë parashikuar të shpenzohen edhe fonde nga të ardhurat e veta për mbështetjen dhe mirëfunksionimin e tyre.

Bashkia ka parashikuar të përfitojë fonde, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit Rajoneve, për disa projekte që kemi aplikuar në fushën e infrastrukturës rrugore vendore, arsimit, kulturës, etj, për të cilat do t,ju informoj rast pas rasti për projektet dhe fondet e përfituara dhe të realizuara, ku deri tani është përfituar zbatimi i projektit “Lulishte e Parkim në Sheshin para Gjimnazit Lezhë me vlerë 25.² milion lekë, ku për vitin 2016 (faza e parë) është akorduar 50 % e fondit ose 12.⁶ milion lekë.

II.Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2016.

Parashikimi i shpenzimeve është 1.195.559.⁹⁵ mijë lekë. Nga shpenzimet e planifikuara synohet përmbushja e detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj, si më poshtë për:

- Administratën vendore;
- Emërgjencat civile;
- Planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit;
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
- Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane;
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbëra publike;
- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;
- Mbledhjen, trajtimin dhe transmetimin e ujërave të ndotura;
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave sipërfaqësore të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në

zonat e banuara;

- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit;
- Shërbimin e dekorit publik;
- Ndriçimin e mjediseve publike;
- Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë;
- Mbështetjen e zhvillimit të biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vendet publike;
- Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj;
- Zhvillimin e turizmit;
- Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes e kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni;
- Administrimin e sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore;
- Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit, këshillimit bujqësor e rural, dhe hartimin e statistikave bujqësore vendore;
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit parashkollor (kopshte e çerdhe) dhe parauniversitar;
- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehim social;
- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, dhe të moshuarit etj;
- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
- Organizimin e aktiviteteve kulturore, promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave dhe ambjenteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve;
- Programe dhe projekte rinore;
- Organizimin e aktiviteteve sportive, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve dhe të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Për planifikimin e fondit të pagave, fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore jemi mbështetur në numrin e punonjësve të paraqitur për miratimin, në nivelin e pagave të miratuara me vendim këshilli, dhe në V.K.M për nivelin e pagave për çdo sektor të transferuar pranë bashkisë, si dhe në normat ligjore të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Bazuar në këto tregues fondi i pagave gjithsej për vitin 2016 është 469.438.⁹¹ mijë lekë, ndërsa fondi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 75.853.¹⁵ mijë lekë. Këto fonde do të përballohen me të ardhurat e veta të bashkisë në masën prej 385.979 mijë lekë, me fondet e kushtëzuara 9.450.⁴ mijë lekë dhe me fondet specifike 149.862.⁶⁶ mijë lekë. Buxheti i paraqitur mbulon me fond page të gjithë punonjësit e aparatit dhe të institucioneve vartëse, sipas nivelit të pagave të miratuara. Sigurimet shoqërore e shëndetësore janë parashikuar në nivelin ligjor prej 16.⁷ % mbi fondin e pagave. Fondi i veçantë është llogaritur 5 % mbi fondin e pagave.

Fondi rezervë është parashikuar 5.000 mijë lekë, dhe fondi i kontigjencës 5.000 lekë, të llogaritur brenda nivelit ligjor, ndërsa Kuota e Qarkut është llogaritur në masën 20.405.⁷⁶ mijë lekë për vitin 2016.

Në buxhetin e paraqitur janë respektuar detyrimet ligjore për përdorimin e grantit në masën 40 % për investime. Investimet për vitin 2016 janë parashikuar 205.401.¹ mijë lekë, të cilat do të financohen nga granti 44.⁹ % ose 92.220 mijë lekë, nga të ardhurat 26.¹ % ose

53.558 mijë lekë, nga buxheti i shtetit 27.⁵ % ose 56.500 mijë lekë dhe nga donatorët 1.⁵ % ose 3123.¹ mijë lekë.

Për programimin sa më objektiv të shpenzimeve operative, jemi mbështetur në analizën e realizimit të shpenzimeve të vitit më parshëm, të detyrimeve të palikujduara të krijuara gjatë viteve në ish-bashki e komuna, të cilët janë parashikuar për likuidim rreth 110.000 mijë lekë, në projekt-preventivat e kërkuara dhe në objektivat e prezantuara para qytetarëve.

Fondi për shpenzime operative do të jetë 374.596.⁰³ mijë lekë, ku fondi për shërbimin e pastrimit, largimin e mbeturinave, gjelbërimit, dekorin dhe shërbimin funeral janë parashikuar në vlerën 100.000 mijë lekë, me qëllim përputhjen sa më të mirë, të kryerjes së këtyre shërbimeve, në sasi e cilësi, në gjithë territorin e bashkisë; me mundësi financiare për të mbuluar këto shërbime plotësisht. Niveli i shpenzimeve operative për aparatën, institucionet arsimore dhe kulturore, çerdhet, etj janë parashikuar për mbulimin e nevojave më të domosdoshme për përiudhën dhe shlyerjen e disa detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e fundit. Për këtë përiudhë janë parashikuar fonde për mirëmbajtjen e ambjentëve arsimore, sociale dhe kulturore, për ndriçimin e qytetit, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuare dhe kanalizime, etj. Fondi për shpërblimin e këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave është 10.944 mijë lekë që zënë 19.⁷ % të shpenzimeve operative administrative.

Bashkia Lezhë, do të vazhdojë të mbështesë me fonde sportet, dhe në veçanti ekipet e futbollit. Fondet e akorduara për sportet janë 50.000 mijë lekë.

Për vitin 2016 është parashikuar fond prej 13.000 mijë lekë për pagesën e kestit të kredisë dhe përqindjes së interesave sipas planit të amortizimit të saj.

Në buxhetin e bashkisë, përveç financimeve nga qeveria, janë përfshirë fonde edhe nga të ardhurat e bashkisë për disa probleme sociale. Kështu do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me Kryqin e Kuq për mirëfunksionimin e Qendrave të Moshës së Tretë; kemi vendosur dhe do të vazhdojmë të mbajmë nga një punonjës për shërbim, marrim përsipër dhe do të vazhdojmë të paguajmë qeranë e shtëpive për 30 familje me kushte strehimi shumë të vështira.

Gjithashtu do të vazhdojmë mbështetjen e projektit të filluar, për barazinë gjinore etj.

Pra në total, shpenzimet gjithsej të bashkisë për vitin 2016 janë parashikuar në vlerën 1.195.559.⁹⁵ mijë lekë.

III. Numri i punonjësve të bashkisë për vitin 2016.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve që kërkohet të miratohet nga ana e këshillit është mbajtur parasysh nevoja për burime njerëzore për realizimi e funksioneve të përcaktuara në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, kërkesave të akteve të tjera ligjore dhe projekt-rekomandimit të dhënë nga M.Çeshtjeve Vendore dhe Projekti Star.

Bashkia Lezhë për vitin 2016 do të organizojë punën e saj në 9 njësi administrative, 11 drejtori, 6 institucione varëse dhe 6 agjensi. Për vitin 2016 bashkisë i janë transferuar edhe 6 funksione të reja, si sektori PMNZSH, personeli mësimor e jomësimor i arsimit parashkollor, personeli jomësimor i arsimit parauniversitar, rrugët rurale, administrimi i pyjeve, dhe ujitja e kullimi.

Për këtë vit është menduar të krijohen dy drejtori të reja në kuadër të zbatimit të VKM Nr.965, datë 02.12.2015, përkatësisht; Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, si dhe Drejtoria e Emërgjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të bashkisë që propozohet për miratim do të jetë 755 vetë, e konkretisht sipas strukturës;

- Punonjës të administratës bashkisë 142 vetë.
- Policë bashkiak 14 vetë.
- Punonjës të njësive administrative 148 vetë.
- Punonjës të institucioneve varëse 50 vetë.

- Punonjës të Agjensive 120 vetë.
- Punonjës me kontratë 6 mujore 50 punonjës (25 vetë vjetore).
- Punonjës funksioneve të deleguara 256 vetë, nga të cilët 243 (dyqind e dyzet e tre) vetë, punonjës të transferuar me funksionet e reja dhe 13 punonjës (11 vetë Gjendja civile dhe 2 vetë Q.K.B._{ja}), që paguhen nga transferta e kushtëzuar.

Numri i punonjësve sipas njësive administrative do të jetë: Nj.A.Shëngjin 30 punonjës, Nj.A. Shënkoll 20 punonjës, Nj.A.Balldre 18 punonjës, Nj.A.Blinisht 13 punonjës, Nj.A.Kallmet 13 punonjës, Nj.A.Dajç 13 punonjës, Nj.A.Zejmen 15 punonjës, Nj.A.Kolsh 13 punonjës dhe Nj.A. Ungrej 13 punonjës.

Të nderuar këshilltarë ;

Buxheti i vitit 2016 nuk mund të jetë një buxhet i zgjidhjes së shumë problemeve afatmesme dhe afat-gjata, por është një buxhet me objektiva të qarta për stabilizimin e gjendjes financiar dhe bazë zhvillimi të bashkisë.

Jam i bindur se realizimi i tij kërkon një impenjim maksimal, i të gjithë punonjëve të aparatit bashkisë,të njësive administrative,të agjensive dhe të institucioneve varëse, por edhe një bashkëpunim mirëkuptues me këshillin e bashkisë, në mënyrë që problemet e konstatuara dhe vështërsitë që do të hasim gjatë zbatimit të tij do t'i kapërcejmë me sukses së bashku, duke vënë në plan të parë rritjen e nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve.

Si përfundim, unë besoj që bashkë me ju, me shumë punë e përkushtim do të marrim e përmbushim përgjegjësitë dhe detyrimet tona për të administruar dhe zhvilluar Lezhën.

Unë besoj në kontributin dhe mbështetjen Tuaj.

K R Y E T A R I

Fran FRROKAJ

Konc. & kompj. Dr.Finnacës Tonine Marku
 Drejtori i të Ardhurave Arben Ndoj
 Drejtori i Burimeve Njerëzore Mark Lleshi
 Drejtori i Drejtorisë Juridike Ndue Vathi